
AKT THEMELIMI

"M Oil" SHPK

1. Forma ligjore, emri i shoqërisë dhe ortakut themelues

Emri i shoqërisë do të jetë **"M Oil" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

Shoqëria zotërohet nga ortakut i vetëm:

- **Z. DENI Mersinaj**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 18.06.2000, banues në Tiranë, Shqipëri, i identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. Personal identifikimi K00618049L.

2. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Tregtimin dhe shpërndarjen me pakice të karburanteve, nënprodukteve të tyre, lendeve djegëse, vajrave lubrifikante, etj. Import- Eksport dhe tregtimin e mallrave dhe artikujve të ndryshëm dhe materialeve të tjera, ka të drejtë të kryejë financime të ndryshme, etj. Administrimi, mirëmbajtja, operimi, shfrytëzimi, transferimi i hidrocentraleve.
- Marrje përsipër të detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kontrata e koncesionit. Tregtimi i energjisë elektrike. Çdo lloj veprimtarie kryesore ose dytësore tjetër që lidhet me këtë objekt.
- Aktivitet në fushën e punimeve të inxhinierisë civile, në përgjithësi ndërtimeve, të tillë si por pa u kufizuar në, projektim, zbatim të ndërtimeve civile, industriale, rrugëve, HEC-eve, prodhimi, përpunimi dhe transportimi i materialeve të ndërtimit. Montimi i konstruksioneve metalike, gërmime dhe mbushje me dhe e materiale të tjera, projektimi, ndërtimi e kolaudimi i rrjeteve të ujërave të çdo lloji, të rrjeteve dhe pajisjeve të energjisë elektrike, të rrjeteve dhe pajisjeve elektronike, të moduleve të komandimit, të sistemeve mbrojtëse e sinjalizuese e çdo gjë tjetër e nevojshme për realizimin e veprave të ndryshme nga projektimi deri në dorëzimin final, 2 përfshirë edhe aktivitete të mirëmbajtjes e riparimit të tyre. Grumbullim dhe tregtim të skrapeve të çdo lloji; Shpime pusesh për ujë dhe me marrje e kampionesh për studimi gjeologjik dhe arkitektonik.

Pa u kufizuar në sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

3. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

- **Rruga "Ali Demi", Shkozë, përballë TV News24, Karburanti Nr.27 Tiranë, Shqipëri.**

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

4. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100,000 (njëqind mijë lekë)**.

Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **ALL 100,000 (njëqind mijë lekë)** dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

6. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

7. Administratori

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është:

- **Z. DENI Mersinaj**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 18.06.2000, banues në Tirane, Shqipëri, i identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. Personal identifikimi K00618049L.

•

8. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM

Z. DENI Mersinaj

Deni Mersinaj 

[emër mbiemër dhe nënshkrimi]

Datë 01.08.2024.
